

GJYKATA KOMUNALE NË PRISHTINË**KA Nr. 263/10****20 janar 2011**

Gjyqtari i EULEX-it, nga Gjykata Komunale në Prishtinë, Charles L. Smith, si gjyqtar për konfirmimin e Aktakuzës, në çështjen penale kundër:

(1) Ukë Muçaj, emri i babait Misin, emri i nënës Shahe, i lindur më 5 mars 1949, në fshatin, Llugë e Epërme, Komuna e Deçanit, aktualisht banon në Pejë, në Rr. "Kulla e Fidanishtes", A, Nr. 11, shqiptar nga Kosova, i martuar me gjashtë fëmijë, ka të përfunduar Shkollën për drejtësi, gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Pejë, nuk është i dënuar më herët;

(2) Viktor Zefi, emri i babait Gjon, emri i nënës Zojë, i lindur më 19 shtator 1967, në fshatin Ranocë, Komuna e Pejës, aktualisht jeton në Rrugën "brigada 135", Dardania 1-8, shqiptar nga Kosova, i martuar, me pesë fëmijë, ka të përfunduar Universitetin, profesioni ushtarak, me gradën e kapitenit, i punësuar në ish TMK, nuk është dënuar më herët;

Të akuzuar për:

Ukë Muçaj, dy akuza të marrjes së ryshfetit, në pajtim me nenin 343, paragrafi 1, I KPK-së, e dënueshme me burgim nga gjashtë deri në pesë vite.;

Viktor Zefi, dy akuza të dhënies së ryshfetit, në pajtim me nenin 344, paragrafi 1, i KPK-së, e dënueshme me burgim nga tre muaj deri në tri vite, dhe një akuzë të mashtrimit, në pajtim me nenin 261, paragrafi 1, i KPK-së, e dënueshme me gjobë, apo me burgim deri në tri vite;

Në pajtim me nenin 316, paragrafi 4, i KPPK-së, me anën e kësaj nxjerr sikurse më poshtë:

AKTVENDIM

Aktakuza e ngritur më 04 nëntor 2010, me anën e kësaj konfirmohet në lidhje me të gjitha akuzat dhe për te gjithë të pandehurit.

ARSYETIM

Historiku procedural

Më 23 mars 2009, Zyra e Prokurorit Special e Mitrovicës ngriti Aktakuzën kundër të pandehurve të lartpërmendur. Pas seancës së konfirmimit të Aktakuzës, e mbajtur më 17 nëntor 2009, Gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës hodhi poshtë të gjitha akuzat.

Prokurori publik bëri ankesën ndaj Aktvendimit dhe më 28 janar 2010, Kolegji prej tre gjyqtarësh e Gjykatës Komunale, vendosi që të e kthej prapa rastin tek Prokurori që të e finalizoj hetimin. Më 04 qershor 2010, Prokurori publik kërkoj vazhdimin e hetimeve e cila u lejua nga Gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës. Hetimi u lejua për një muaj, dhe pas saj Aktakuza do të ngritet apo të konsiderohet që Prokuroria të tërhiqet nga Aktakuza.

Më 04 nëntor 2010, Prokuroria publike, në përputhje me udhëzimet e marra nga Gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës ngriti Aktakuzën e cila është rezultat i hapave të tjerë hetues të ndërmarra nga janari deri në nëntor 2010. Kështu, Aktakuza e ngritur më 04 nëntor përfaqëson një version të ndryshuar të Aktakuzës fillestare, e ngritur më 23 mars, të vitit 2009.

Heqja dorë nga shqyrtimi i Aktakuzës

Asnjë heqje dorë në të shkruar nuk është ngritur në dosjen e lëndës nga ana e të pandehurit; prandaj, seanca për konfirmimin e Aktakuzës u vazhdoi sikurse u caktua, në pajtim me nenet 309, 310, 311, të KPPK-së.

Deklarimi i të pandehurve

Të gjithë të pandehurit janë deklaruar jo fajtor për të gjitha akuzat.

Parashtresat e palëve

Në pajtim me nenin 314, paragrafin 5, të KPPK-së palët kanë paraqitur deklaratat e tyre.

Parashtresat e avokatëve mbrojtës

Avokati mbrojtës, Orhan Basha, në parashtresën e tij ka theksuar se nisma e hetimeve është ilegale. Gjithashtu ai përmendi faktin se nuk ka qartësime lidhur me besimin mbi Aktakuzën e parë, dhe Aktakuza e dytë do të jetë shkelje e ligjit, në kundërshtim me *non bis idem principle*, prandaj, gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës duhet që të e hedh poshtë Aktakuzën e dytë.

Për më shumë, avokati mbrojtës, theksoj se Aktakuzës i mungojnë dëshmitë dhe se hetimi mbi këtë rast ka zgjatur më shumë se afati i paraparë me ligj, kështu, me tejkalimin e këtij afati ligjor Prokurori hoqi dorë nga e drejta që të ngre Aktakuzën.

Avokati mbrojtës, Zeqir Bërdyna, theksoj faktin se çdo vazhdim i hetimeve i lejuar për këtë rast është ilegale, pasi që në pajtim me nenin 225, të KPP-së, vetëm në rastet kur me ligj parashihet dënimi me 5 vite mund të lejohet vazhdimi, e cila nuk vlen për këtë rast, pasi që veprat penale për të cilat klienti im është akuzuar, dënimi me burgim është deri në

tri vite. Për më shumë, ai nënvizoj faktin se deklarata të cilën klienti i tij e ka dhënë në polici është e papranueshme, pasi që klientit të tij nuk i kanë thënë se ai ka të drejtë për avokat mbrojtës, ai nuk e ka lexuar deklaratën para se të e nënshkruaj. Për të gjitha këto arsye, Gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës duhet të e hedh poshtë Aktakuzën.

Parashtrësit e të pandehurve

Të gjithë të pandehurit qëndruan pas fjalimeve të dhëna nga avokatët e tyre mbrojtës. Në veçanti, Z. Zefi argumentoi se deklarata e dhënë në polici nuk është marrë në pajtim me dispozitat e ligjit. Ai gjithashtu përmendi se ai nuk e dinte se ku Ukë Muçaj jetonte, dhe se kurë nuk kishte pirë kafe me Ukë Muçajn.

Nga ana e tij, Z. Muçaj, deklaroi, *inter alia*, se atij i kujtohej shumë mirë fundi i javës, kur dyshohet se ka pranuar vizitë dhe të holla nga Viktor Zefi, dhe ai thotë se ishte në këtë shtëpinë fshat, jo në banesë, kështu ky takim nuk mund të bëhej.

Parashtrësia e Prokurorisë

Prokurori publik kërkoi nga gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës që të e konfirmoi Aktakuzën në tërësi.

ÇËSHTJET LIGJORE

Pranueshmëria e dëshmimeve

E vetmja dëshmi e sfiduar nga palët në këtë fazë të procedurës është deklarata e dhënë nga Viktor Zefi, në polici. Nga vlerësimi i kujdesshëm i deklaratës së përmendur, gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës vë re se të gjitha paralajmërimet e përshkruara me ligj i janë dhënë të dyshuarit, dhe se ai ka nënshkruar çdo faqe të deklaratës së përmendur. Kështu, gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës nuk gjen asnjë arsye që të e deklaroi këtë dëshmi të papranueshme.

Aktakuza të ngritë dyshimet e bazuara mirë

Gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës deklaroi se çdo analizë e dosjes, e kryer në këtë fazë të procedurave duhet që të bëhet në atë mënyrë në mënyrë që të mos paragjykoj në asnjë mënyrë rezultatin e shqyrtimit kryesor, sikurse kërkohet me nenin 317, paragrafi 2, i KPPK-së.

Duke u bazuar mbi këtë supozim, gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës konsideron se dëshmia e prezantuar në dosje të lëndës ka më shumë gjasa se sa të mos e siguroj vendimin e fajësisë në fund të shqyrtimit kryesor. Pra, Gjyqtari vë re se deklaratat e dhëna nga File dhe Prek Ndrecaj janë dëshmi vërtetuese. Nuk kishte arsye, sipas mendimit të Gjyqtarit që të shpikë histori që të dëmtoj ndokënd të cilët kurrë nuk ishin takuar. Për më shumë, deklarata e të akuzuarit Viktor Zefi, jep detaje interesante të cilat e vërtetojnë historinë të dhënë nga anëtarët e familjes Ndrecaj. Të gjitha këto deklarata

kanë dhënë fotografi të plotë të situatës faktike të cilat përmbushin standardin e dyshimit të bazuar mirë, e kërkuar me ligj.

Çfarëdo pyetje që mund të ngritët sa i përket besueshmërisë së këtyre dëshmitarëve duhet që të vlerësohet nga Paneli gjyqësor, gjithashtu edhe çfarëdo dëshmi shfajësuese e cila mund të sillët nga mbrojtja, që është për të thënë, Z. Muçaj, pretendon se në natën inkriminuese ai nuk ishte në vendbanimin e treguar nga dëshmitarët. Nuk ka arsye për këtë Gjyqtar që të mos e besoj deklaratën e Z. Muçaj, por nuk është në mandatin e këtij Gjyqtari që të vendos mbi alibin e mbrojtjes. Për të gjitha këto elemente duhet në mënyrë të duhur të merremi në shqyrtimin kryesor. Më tutje, është ven në dukje nga avokatët mbrojtës se ekzistonte mungesa e dëshmimeve të drejtpërdrejta të dorëzimit të ryshfetit. Gjykata vë re se ekziston dëshmia që i referohet e cila mund të karakterizohet si dëshmi e varur nga rrethanat. Është për Panelin gjyqësor që të ekzaminoj mjaftueshmërinë e rrethanave të varura që të përcaktoj nëse do të mbështet gjetjen e fajësisë apo të ekzaminoj nëse ekzistojnë shpjegime të tjera të logjikshme për rrethana të tilla të varura. Gjyqtari për konfirmimin e Aktakuzës duhet që të përcaktoj nëse dëshmitë e shikuara si tërësi arrijnë cakun e përcaktimit se është dyshim i bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale të cekur në Aktakuzë. Gjykata ka bër një përcaktim të tillë.

Për të gjitha këto arsye, është vendosur sikurse në diapozitiv.

Charles L. Smith
Gjyqtar për Konfirmimin e Aktakuzës i EULEX-it

Këshilla Ligjore:

Asnjë ankesë nuk lejohet kundër këtij Aktvendimi, pasi që neni 317, paragrafi 2, i KPPK-së, si "*lex specialis*" lejon ankesën vetëm për Prokurorin dhe palën e dëmtuar në rast të hedhjes poshtë të Aktakuzës.